



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 7477 Prot.

Tiranë, më 12.07. 2018

URDHËR

NR. 401, DATË 12.07. 2018

PËR

CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT TË VITIT AKADEMIK 2018 - 2019 NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 1 të nenit 87 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Viti akademik 2018 - 2019 në institucionet e arsimit të lartë, të fillojë në datën 15 tetor 2018 dhe të përfundojë në datën 30 shtator 2019.
2. Periudha 24 dhjetor 2018 deri në 4 janar 2019, të jetë periudhë pushimesh për studentët.
3. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit të kandidatëve fitues, të dërgojnë në të gjitha ndërmarrjet “Trajtimi i Studentëve” sh. a., listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR


Lindita NIKOLLA

